



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

KRYETARI

Nr. 16876 prot.

Vlorë, më 16.10 2025

V E N D I M

Nr. 154 , Datë 16.10 . 2025

**PËR PËRCAKTIMIN E VENDEVE PUBLIKE TË LEJUARA PËR AFISHIMIN E
MATERIALEVE PROPAGANDISTIKE E EDUKUESE DHE RREGULLAT PËR
AFISHIMIN E TYRE GJATË FUSHATËS PËR ZGJEDHJET E PJESSHME
VENDORE**

Bazuar në ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, në mbështetje të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 2, pika 1, neni 78, neni 79, të tij, Udhëzimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nr.6 datë 23. 03.2021, “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”, të ndryshuar, Vendimit nr.37 datë 06.10.2025, të Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 9 Nëntor 2025,

V E N D O S A:

- 1) Përcaktimin e kriterëve dhe vendeve të lejuara në territorin e Bashkisë Vlorë për afishimin e materialeve edukuese zgjedhore dhe propagandistike nga partitë politike dhe subjektet zgjedhore, vendeve në dispozicion të KQZ dhe palëve të treta, që nuk promovojnë fushatën e një subjekti të caktuar zgjedhor (materiale edukative zgjedhore, të cilat i shërbejnë edukimit të zgjedhësve), hapësira këto që sigurojnë shikueshmëri publike.
- 2) Ambientet publike me akses të plotë dhe hapësirë të bollshme për publikun, për afishimin e materialeve edukative zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 9 nëntor 2025 janë: Ambienti i pritjes së qytetarëve në Bashkinë Vlorë (One Stop Shop), këndi i publikimeve pranë Bashkisë Vlorë, të gjitha këndet e publikimeve në Rajonet dhe Njësitë Administrative, Bashkia Vlorë, si dhe pranë qendrave të votimit.
- 3) Materialet propagandistike zgjedhore dhe sendet e lejuara për fushatë zgjedhore lejohen të afishohen vetëm deri në një distancë prej 5 metra nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor përkatës, dhe jo më parë se data 1 nëntor 2025.

- 4) Ndalohet afishimi i materialeve proagandistike në fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit, shtyllat e ndriçimit dhe mjetet që operojnë në transportin publik.
- 5) Të gjitha materialet propagandistike vizive, që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin "Printuar nën përgjegjësinë ligjore të ... (emri i subjektit zgjedhor)
- 6) Zyrat zgjedhore të subjekteve zgjedhore mund të hapen në një distancë jo më të vogël se 300 (treqind) metra nga vendndodhja e KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-ve.
- 7) Ndalohet përdorimi i materialeve propaganduese me natyrë ndotëse, si dhe përdorimi i materialeve propaganduese në kundërshtim me përcaktimet e bëra në këtë vendim, që përbëjnë dëmtim apo cënim të hapësirave apo investimeve publike, të cilat do të rikuperohen në gjendjen fillestare me kosto të vet partisë politike apo subjektit zgjedhor.
- 8) Ndalohet në perimetrim prej 150 metra rreth qendrës së votimit intimidimi si dhe sjelljet agresive frikësuese, shantazhuese dhe kërcënuese të çdo lloji forme, çdo veprim që pengon apo ndërhyr në hyrje daljen ose aksesin e zgjedhësve në ambientet e votimit si dhe vendosja e materialeve që synojnë të ndikojnë tek votuesit.
- 9) Bashkia nëpërmjet organeve ligjzbatuese, do të heqë të gjitha materialet propagandistike të subjekteve zgjedhore, që publikohen jashtë përcaktimeve të këtij vendimi dhe që janë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në dispozitat përkatëse të Kodit Zgjedhor, vendimet e KSHZ-it dhe Komisionit Rregullator.
- 10) Subjektet zgjedhore duhet të njoftojnë me shkrim Kryetarin e bashkisë për hapjen e zyrave zgjedhore me adresat e sakta të tyre.
- 11) Partitë politike dhe subjektet zgjedhore duhet ti përmbahen dispozitave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, dhe me mbarimin e fushatës zgjedhore, të marrin masat për heqjen e gjithë materialeve propagandistike.
- 12) Ngarkohet Policia Bashkiake, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Vlorë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Administratorët e Rajoneve/ Njësi Administrative të Bashkisë Vlorë për të garantuar zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim i dërgohet për njohje KQZ-së, Prefektit të Qarkut Vlorë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë.

KRYETAR
Elis Halili

